




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.4, datë 24.02.2022

PËR

MIRATIMIN “KËRKESË PËR TRANSFERIM TË LEJES/AUTORIZIMIT”, NGA SHOQËRIA “FAVINA” SH.P.K. TE SHOQËRIA “OSOJA-HPP” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman,

V E N D O S I:

1. Miratimin e transferimit të lejes Nr.1204, datë 30.10.2018 miratuar nga KBU Seman me Vendim Nr.22. datë 25.10.2018, për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike HEC “Osoje”, nga subjekti “Favina” sh.p.k. me NIPT J64104078V te subjekti “Osoja-HPP” sh.p.k. me NIPT L83719003E, me vendndodhje në lumin Osojë, degë e lumit Devoll, Bashkia Maliq, Qarku Korçë.
2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

Vepra e marrjes

- X=543911.92
- Y=4503906.67
- Z=818 m.m.n.d

Godina e centralit, Vendi i shkarkimit

- X=541712.25
- Y=4504288.47
- Z=655 m.m.n.d

Qmes=1.184 m³/sek

Qllog=1.430 m³/sek

Qeko=0.210 m³/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

